



| | |
|---|--------------------|
| REPublika e Kosoves/REPublika Kosova/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr Prot. |
| Dep. 03-02/DPK | Br Prot 01-1624/16 |
| Dep. | Prot No |
| Nr. I faq | Data |
| Broj. stranica | Datum |
| Nr. pages 02 | Date 27-04-2016 |
| PRISHINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.04.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4300/15, për z. Cenë Behrami – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4300/15, për z. Cenë Behrami – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Skenderajt, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat “Lindi Print”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Behrami në fillim është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

Zyrtari i lartë është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksione menaxhuese në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar se brenda afatit do t’i bëj ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci informatat mbi biznesin privat, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se z. Behrami ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

